VENDIM
Nr.3, datë 17.1.2008

PËR KËRKESËN E SHOQËRISË "BIOPOWER GREEN ENERGY" SHPK PËR KUALIFIKIMIN E IMPIANTEVE PRODHUESE (PARK EOLIK BPGE1 DHE BPGE2, BALLDREN, LEZHË) SI BURIME TË RINOVUESHME ENERGJIE

Në mbështetje të nenit 9 dhe nenit 39, pika 2 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, nenit 8 të "Rregullores së procedurave të certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme", i propozojmë Bordit të Komisionerëve të ERE-s , vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.44, datë 24.7.2007 "Për miratimin e rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s" neni 38, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike "ERE", në mbledhjen e tij të datës 17.1.2008, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë "Biopower Green Energy" sh.p.k., për kualifikimin e impianteve prodhuese (Park eolik BPGE1 dhe BPGE2, Balldren, Lezhë) si burime të rinovueshme energjie,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë "Biopower Green Energy" sh.p.k., për kualifikimin e impianteve prodhuese (Park eolik BPGE1 dhe BPGE2, Balldren, Lezhë) si burime të rinovueshme energjie.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtoria e Çështjeve Ligjore dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojnë aplikuesin lidhur me plotësimin e dokumentacionit të munguar dhe me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta